



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

MANUAL TEKNIK

Nr. 01, datë 08.05.2024


PËR

**“KRIJIMIN E NJOFTIMIT PARAPRAK TË INFORMACIONIT NË SISTEMIN E
PROKURIMIT ELEKTRONIK”**


Referuar Nenit 57 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik”, autoritetet kontraktore mund të japin informacion për prokurimet e planifikuara nëpërmjet shpalljes së një njoftimi paraprak të informacionit.

Këto njoftime përmbajnë informacionin, i cili përcaktohet në rregullat e prokurimit publik dhe shpallen në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.


Për të krijuar njoftimin paraprak të informacionit, nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të shkojë tek “Vendi i Punës”, në skedarin “Shto Regjistër Parashikimi” dhe tek nyja “Të Publikuara” shfaqen të gjithë elementët e regjistrit të cilët janë publikuar.



Në këto momente përzgjedh elementin e regjistrit për të cilin do të krijojë një njoftim paraprak informacioni dhe klikon mbi tabin “Shto Njoftim Paraprak të Informacionit”.




Menjëherë shfaqet forma për tu plotësuar si më poshtë:



Nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të plotësojë fushën “Subjekti” në të cilin duhet të vendosë objektin e njoftimit paraparak të informacionit. Në fushën “Përshkrimi” duhet të japë detaje rreth njoftimit.

Më pas, duhet të klikojë “Shto Njoftimin” për të ngarkuar formularin e Njoftimit paraparak të Informacionit në formatin doc ose docx, i cili është pjesë e dokumentave standarde të tenderit.



Njoftimi Paraprak i Informacionit

Njoftimi Paraprak i Informacionit

Subjekti Blerje materiale kancelarie

Përshkrimi Përshkrimi

Dokumentet e Njoftimit

Dosje

Njoftim Paraprak Informacioni.pdf. Skedar. *Bashkangjit*

Shto Njoftimin

Autoriteti Kontraktues Agjencia e Prokurimit Publik


Numri i Njoftimit CN/29144/02152024 **Krijuar nga** admin

Tipi i Njoftimit Njoftimi Paraprak i Informacionit


Hapi Tjetër Mbyll

Më pas, nëpunësi i autorizuar duhet të klikojë butonin “Hapi Tjetër” dhe në dritaren që shfaqet duhet të klikojë butonin “Ok” nëse është i sigurt që do të dërgojë njoftimin për publikim.

Në këtë moment, njoftimi paraprak i informacionit i krijuar në sistem nga nëpunësi i autorizuar është dërguar për publikim në APP.




Krijimi i njoftimit paraparak të informacionit në SPE është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në rastet kur ka nevojë për plotësime, në rubrikë “Arsyet e Refuzimit”, jepen komentet përkatëse.



Për të ngarkuar edhe njëherë njoftimin paraprak të informacionit, në rastin kur nuk do të publikohet, duhet të ndiqen edhe njëherë hapat e sipërcituar.

Në rast se njoftimi paraprak i informacioni do të publikohet, atëherë automatikisht do të shkojë në njëjën “Njoftim Paraprak Informacioni -> Të Publikuara”



“Njoftimi paraprak i informacionit” pasi publikohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik, do të botohet edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.